



This project is funded by  
the European Union



Empowered lives.  
Resilient nations.

## **FTESË PËR PJESËMARRJE NË DITËN E HAPUR/SESION INFORMUES MBI: THIRRJEN E DYTË PUBLIKE PËR ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE NË TROPOJË**

Programi Rajonal për Demokraci Vendore në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD) financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor, përfshirë: Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Kosovën<sup>1</sup>, Republikën e Maqedonisë së Veriut, Malin e Zi dhe Serbinë. Qëllimi i përgjithshëm është të fuqizojë demokracitë pjesëmarrëse dhe procesin e integritit në BE në Ballkanin Perëndimor, duke e fuqizuar shoqërinë civile që të jetë pjesë e proceseve të vendimmarrjes si dhe duke kontribuar dhe mundësuar një mjedis ligjor dhe financiar inkurajues për shoqërinë civile. Në kuadër të këtij programi, në Shqipëri pritet të zbatohen rreth 50 projekte të OSHC-ve në 12 bashkitë partnere<sup>2</sup>.

Bashkia **Tropojë** në bashkëpunim me stafin e projektit ReLOaD në Shqipëri ka shpallur më **13/02/2019** Thirrjen e dytë publike për OSHC-të e cila do të jetë e hapur deri më **27/03/2019**. Me qëllim mbështetjen e OSHC-ve për të paraqitur aplikime në përputhje me kriteret e Udhëzuesit, projekti ReLOaD do të organizojë një ditë të hapur/sesion informimi dhe një trajnim 3-ditor mbi “Ciklin e Manaxhimit të Projekteve”. Në këto aktivitete ftohen të marrin pjesë të gjitha organizatat e interesuara për të aplikuar në Thirrjen.

### **1. Dita e hapur organizohet më 11 Mars 2019**

### **2. Trajnimi “Ciklin e Manaxhimit të Projekteve” organizohet në datat 11-12-13 Mars 2019**



Axhenda  
Tropoje.docx

Këto aktivitete do të zhvillohet pranë **Bashkisë Tropojë** sipas axhendës:

09:00 - 09:30 Fjala e mirëseardhjes nga përfaqësues të Bashkisë Tropojë

09:30 - 11:30 Prezantim i thirrjes së dytë publike për OSHC-të në Bashkinë Tropojë - stafi ReLOaD

11:30 – 13:00 Pyetje/diskutime rreth Thirrjes së dytë publike për OSHC-të në Bashkinë Tropojë.

13:00 – 14:00 Pushim Dreke

14:00 – 17:30 Sesioni i parë i trajnimit mbi “Ciklin e Manaxhimit të Projekteve” për OSHC-të

<sup>1</sup> Të gjitha referencat lidhur me Kosovën duhet të kuptohen në përputhje të plotë me Rezolutën 1244 (1999)

<sup>2</sup> Durrës, Dibër, Shkodër, Përrenjas, Elbasan, Korçë, Librazhd, Tiranë, Tropojë, Roskovec, Përmet and Lezhë